

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.


Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimi i punonjësive dhe institucioneve, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi e përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrit të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajit Mars, 2024

Tirana mbledh në një konferencë ndërkombëtare drejtues dhe profesionistë publikë dhe jo-publikë të luftës kundër korrupsionit

04-05.03.2024: Zhvillohet në Tiranë konferenca ndërkombëtare rajonale “Forcimi i Llogaridhënies: Fuqizimi i përpjekjeve kundër korrupsionit në Ballkanin Perëndimor”. Ministria e Drejtësisë, Ministri Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, të Shqipërisë së bashku me organizatën Iniciativa Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (GI-TOC) mikpritën në Tiranë për dy ditë të plota, funksionare të lartë politikë, zyrtarë të fushës së drejtësisë, të policive, hartues dhe studiues të politikave kundër korrupsionit, profesionistë të agjencive kundër korrupsionit, profesorë dhe akademikë universitarë si dhe stafe të organizatave të shoqërisë civile. Konferenca me fokus diskutimin e politikave të luftës kundër korrupsionit dhe bashkë-diskutimin e nismave dhe mekanizmave shtetërore dhe jo-shtetërore bëri bashkë të 6 vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe Kroacinë. Kjo konferencë është e dyta që zhvillohet, pas një periudhe dy-vjeçare dhe zgjodhi pikërisht Tiranën si qendrën e rajonit. 150 zyrtarë dhe pjesëmarrës profesionistë të fushës, për dy ditë u ulën në 8 panele teknike diskutimi duke bashkërenduar orientimin e politikave të luftës kundër korrupsionit për të ardhmen e rajonit. Folësit në konferencë sollën raste të vullnetit politik dhe udhëheqës për promovimin e kulturës së integritetit (paneli 1); promovimin e transparencës për financat e partive politike (paneli 2); strategjitë kombëtare dhe eksperiencat në parandalimin e korrupsionit (paneli 3); angazhimet ndërkombëtare kundër korrupsionit në vendet e Ballkanit (paneli 4); përmirësimi i integritetit të prokurorive në luftën kundër korrupsionit (paneli 5); përmirësimi i integritetit të policive në luftën kundër korrupsionit (paneli 6); roli i grave në forcimin e integritetit në institucionet publike (paneli 7) dhe shoqëria civile e edukimi në luftën kundër korrupsionit (paneli 8).



Më shumë informacion mund të gjeni në: <https://www.linkedin.com/company/88693364/admin/feed/posts/>

Shqipëri - Shtete të Bashkuara të Amerikës në partneritet strategjik kundër korrupsionit

18.03.2024: Lufta kundër korrupsionit mbetet urë bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe Departamentit Amerikan të Shtetit. Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, znj. Adea Pirdeni, konfirmoi angazhimet e qeverisë së Shqipërisë, tashmë edhe me krijimin e një portofoli qeveritar antikorrupsion, në luftën kundër korrupsionit si pjesë e agjendës shtetërore. Kuadri strategjik antikorrupsion, bashkëpunimi i vazhdueshëm me organet e Reformës në Drejtësi, intensifikimi i ndërhyrjeve për ti dhënë fund mosndëshkimit në luftën kundër korrupsionit ishin tema të bisedës institucionale në takimin e zhvilluar me këtë rast, në vizitën shtetërore të kryer në Tiranë, nga Ndhmës Sekretari z. Todd Robinson. Partneriteti strategjik në fuqizimin e llogaridhënies dhe konsolidimin e institucioneve demokratike të vendit mbeten çështjet e interesit të përbashkët mes dy vendeve, Shqipëri-Shtete të Bashkuara të Amerikës. Lufta kundër korrupsionit mbetet strategjia që udhëheq politikën prioritare të vendit, të hyrë tashmë në një fazë implementimi të sigurtë dhe pakthim të drejtësisë dhe sistemit publik.

Ministri Pirdeni raporton në Bruksel për zbatimin e reformave në drejtësi dhe kundër korrupsionit

20 - 21.3.2024: Shqipëria raporton ecurinë e reformës në drejtësi, efikasitetin dhe eficensën e reformës së luftës kundër korrupsionit si pjesë e konsolidimit të shtetit të së drejtës, para strukturave teknike të Komisionit Evropian në Bruksel. Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, znj. Adea Pirdeni, drejtoi delegacionin e shtetit shqiptar, të përbërë nga zyrtarë të lartë të administratës publike të vendit, në takimet teknike dhe me qëllim prezantimin e punëve të kryera dhe mbi ecurinë e reformave jetike në vend. Takimi i parë i Nënkomitetit të 15-të për Drejtësi, Liri dhe Siguri, Shqipëria raportoi hollësisht për zbatimin e politikave prioritare të fushës së drejtësisë (duke u ndaluar tek veprimtaria e organeve të drejtësisë), tek lufta kundër korrupsionit (duke u ndaluar tek shifrat e ndëshkimeve të dhëna), tek përmirësimi i kuadrit legjislativ dhe strategjik për të përmbushur kërkesat e BE dhe GRECO-s (duke u ndaluar tek paketat ligjore të fushës dhe objektivet specifike të strategjisë antikorrupsion) si dhe tek masat për të parandaluar korrupsionin në sektorët me risk të lartë. Përafrimi i standardeve të BE për garantimin e të drejtave themelore të njeriut, si pjesë e udhërrëfyesit të kapitullit 23: Shteti i së Drejtës, u diskutuan gjithashtu në takime.



Seanca plenare e GRECO-s vijon vlerësimin e vendeve për integritetin e autoriteteve publike

18 - 22.03.2024: Grupi i Shteteve të Këshillit të Evropës Kundër Korrupsionit – GRECO, zhvilloi punimet e seancës plenare të dytë për vitin 2024. Seanca javore plenare e zhvilluar në godinën e Këshillit të Evropës në Strasburg, në Francë mbledhi bashkë përfaqësues të delegacioneve shtetërore të vendeve anëtare, ku agjendë e diskutimeve ishin vlerësimi i vendeve për ruajtjen dhe standardet e tyre shtetërore në parimet e integritetit nga autoritetet publike në nivel qeveritar dhe ato të autoriteteve ligjzbatuese (policitë). Italia, Lituania, Armenia, Gjeorgjia, Greqi, Francë e Belgjikë vijuan me vlerësimet për Raundin V të tyre: Parandalimi i korrupsionit dhe promovimin e integritetit të zyrtarët e lartë dhe agjencitë e zbatimit të ligjit. Ndërkohë ka ende vende që raportojnë në GRECO për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve për raundet 2 dhe 4, si Kazakistan, Zvicër, gjithashtu Belgjikë e Gjermani. Shqipëria u përfaqësua në punimet e javës plenare nga drejtori i Programeve dhe Projekteve Antikorrupsion, znj. Rovena Pregja. Shqipëria ka kryer deri më tani vetëm ciklin e parë të vlerësimit të raundit V të Vlerësimit, ndërkohë që vlerësimi vijon. Në muajt në vijim, pritet të dorëzohet raportimi i radhës në GRECO, me qëllim mbylljen e këtij raundi nga Shqipëria. Gjithashtu, pritet që GRECO të shpallë raundin e VI të Vlerësimit, në vitin 2025, me fokus organizimin dhe funksionimin e autoriteteve të pushtetit vendor.

Transparency International gjen një partner të besueshëm në analizën e nismave të luftës kundër korrupsionit në Shqipëri

05 - 06.03.2024: Bashkëpunimi dhe ndërkombëtarizimi i masave të luftës kundër korrupsionit kanë nxitur koordinimin dhe formalizimin e marrëdhënieve shtetërore edhe me organizatat jo-qeveritare. Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, znj. Adea Pirdeni, gjithashtu edhe Ministri i Drejtësisë, në cilësinë e ish Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, z. Ulsi Manja, kanë zhvilluar takime pune me drejtorin ekzekutiv të *Transparency International*, z. Daniel Eriksson. Metoda dhe mënyrat e bashkëpunimit të Qeverisë Shqiptare për të forcuar muret mbrojtëse ndaj korrupsionit përmes instrumenteve të forcimit të integritetit dhe përqafimit të digjitalizimit, transparenca në vendimmarrje dhe reformat strukturore në fushat me risk të lartë korrupsionit, si rruga e duhur për të pasur një shoqëri imune ndaj korrupsionit u diskutuan në takime. Në indeksin e perceptimit të korrupsionit të publikuar nga



Transparency International, në vitet e fundit, Shqipëria ka shënuar rritje të lehta, dhe vende më lart në rankimin e 180 vendeve të botës.




Paketa e masave të luftës kundër korrupsionit, si pjesë e Agjendës së Reformave për planin e zgjerimit të BE në Ballkan

29.03.2024: Agjenda e Reformave si pjesë e planit të zgjerimit për vendet e Ballkanit Perëndimor u konsultua në një takim të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian, për kapitujt 23 dhe 24. Pjesë esenciale e Agjendës së Reformave janë edhe dimensionet e masave të luftës kundër korrupsionit. Bashkëpunimi me Organizatat vendase të Shoqërisë Civile tashmë ka përfshirë edhe grup-masat e paketës së zgjerimit, pasi inpute dhe propozime direkte nga aktorët e shoqërisë civile janë me rëndësi zhvillimi dhe zbatimi. Agjenda e Reformave - paketa antikorrupsioni, përmban masa për të cilat janë parashikuar disa hapa për veprim (cilësore dhe sasore), si pjesë e reformave indikative me qëllime parandalimi kryesisht, por ndër to ka edhe iniciativa që prekin dhe synojnë performancën operationale të organeve të drejtësisë me natyrë ligjzbatuese, në luftën kundër korrupsionit. Masat janë produkt i një bashkërendimi propozimesh të bëra nga pala shqiptare dhe nën mentorimin e Komisionit Evropian, me afate për zbatim deri në vitin 2027 dhe për të cilët janë parashikuar indikatorë rezultati me trende rritës. Masat e paketës antikorrupsioni ndahen në masa me efekte ligjore dhe derregullimi (1) dhe masa për vendosje mekanizmesh antikorrupsioni (2). Si pjesë e grupit 1 përmenden: Përafrimi i ligjit për sinjalizuesit; Kuadri ligjor për donacionet dhe sponsorizimet i ndryshuar në përputhje me standardet evropiane dhe GRECO; Udhëzimet e përgjithshme për hetimet financiare të miratuar nga SPAK si dhe ngritja e një platforme për mbledhjen e të dhënave në lidhje me korrupsionin dhe krimet e tjera të rënda, e përditësuar rregullisht, me qëllim identifikimin e tendencave të korrupsionit. Si pjesë e grupit 2 përmenden: Forcimi i transparencës publike të administratës shqiptare ku përmendet krijimi i një platforme të hapur të të dhënave për buxhetin kombëtar dhe vendor dhe shpenzimet publike në partneritet me shoqërinë civile; Publikimi i të gjitha deklaratave të pasurisë në faqen e internetit të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit dhe rritja e kontroleve dhe verifikimeve të deklaratave të pasurisë për çdo vit, mbështetur tek rastet dhe indicie për kontroll të marra; Hetime dhe procedime penale për raste korrupsioni, përfshirë edhe për zyrtarë me nivel të lartë (trend rritës). Agjenda e Reformave pritet të miratohet nga Këshilli i Ministrave të Shqipërisë.



Projekti “Edukimi kundër korrupsionit” mbledh mësuesit e 12 shkollave të vendit për përgatitjen e një plani pune për nxënësit dhe programin mësimor

06 - 28.03.2024: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit ka nisur ciklin e takimeve – trajnim me mësuesit e shkollave të mesme, që do të jenë pjesë e projektit “Edukimi kundër korrupsionit”. Ekspertë të politikave kundër korrupsionit, ekspertët të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Para-universitar dhe Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, ekspertë të fushës së drejtësisë, administratës publike dhe me fokus rritjen e vigjilencës qytetare të kontraktuar nga Ambasada e Italisë në Tiranë, u bënë bashkë me mësues të lëndës “Qytetaria” nga 6 shkolla të mesme të arsimit të lartë të Tiranës dhe 6 shkolla të rretheve Shkodër, Vlorë, Durrës, Korçë dhe Gjirokastrë. Dy takime të dedikuara për mësuesit në Tiranë dhe online për ata të rretheve u zhvilluan në kuadër të projektit të bashkëpunimit të nënshkruar midis ministrave të Drejtësisë, të Arsimit dhe Sportit të Shqipërisë dhe të Ambasadës së Italisë në Shqipëri, në 4 dhjetor 2023. Qëllimi i trajnimit ishte prezantimi i mësuesve të lëndës “Qytetaria” me konceptet dhe metodat e luftës kundër korrupsionit në shoqëri, të formave të angazhimit qytetar drejt parimeve themelore të shtetit të së drejtës dhe të përgatitjes së materialeve informuese të përdorshme për moshën e nxënësve të klasave të 10-ta. Projekti pritet të shkojë në takime të vogla në shkolla për të rritur bashkëpunimin me nxënësit nga afër.



Këshilltarët politikë të ministrave përfitues të programit të trajnimit HELP të Këshillit të Evropës, për kurrikulën e integritetit

01.03.2024: Informimit të rregullt dhe të vazhduar për integritetin dhe kuadrin e luftës kundër korrupsionit për administratën publike të vendit i është shtuar edhe programi HELP, i Këshillit të Evropës. Si rezultat i një bashkëpunimi eficient me zyrën e Këshillit të Evropës në Tiranë legjislacioni shqiptar në fuqi dhe praktika e institucioneve publike përgjegjëse për forcimin e integritetit, iu bashkuan kurseve bashkëkohore për edukimin online mbi integritetin. Ky modul trajnimi, në gjuhën shqipe, iu shtua kurrikulës së Shkollës Shqiptare të Administratës Publike-ASP. Moduli u prezantua në një event publik nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, znj. Adea Pirdeni, drejtuesit të Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, znj. Giulia Re, së bashku me drejtues të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, Departamentit të Administratës Publike, Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit dhe Programin e Këshillit të Evropës për Edukimin e të Drejtave të Njeriut për Profesionistët Ligjorë - HELP. Kurrikula ndihmon në sensibilizimin për format e korrupsionit dhe mjetet e parandalimit të tij, etikën dhe se si kodet e sjelljes promovojnë sjellje etike, konfliktet e interesit dhe mënyrat e menaxhimit të këtyre situatave, qëllimin dhe zbatimin e kufizimeve pas-punësimit, rregullimin e menaxhimit të dhuratave, qëllimet e sistemeve të deklarimit të pasurive, rolin e aksesit të lirë në informacion në parandalimin e korrupsionit, rregullimin e aktiviteteve të lobimit, transparencën e financimit politik, mbrojtjen e personave që njoftojnë për veprime të paligjshme, risqet e korrupsionit në prokurimet publike dhe masat për të ulur këto risqe, dhe rolin e auditimit në luftën kundër korrupsionit. Nëpërmjet shembujve dhe skenarëve praktik, kurrikula fokusohet në dilemat etike dhe sfidat në zbatimin e masave kundër korrupsionit. Pas përfundimit të kursit, këshilltarët politikë do të përfitojnë një certifikatë të lëshuar nga Këshilli i Evropës dhe ASPA.

